



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 73, datë 03.03.2021

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË GJYQTARËVE QË DO TË CAKTOHEN
PËR TË GJYKUAR ÇËSHTJE GJYQËSORE URGJENTE
NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 72, datë 03.03.2021, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, mbi rezultatet e shortit të hedhur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që caktohen për gjykuar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjet në lëndë penale që kanë të bëjnë me kërkesa gjatë hetimeve paraprake (masa sigurimi dhe kërkesa të tjera) dhe me kërkesa që i përkasin kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake, si dhe për çështjet në lëndë civile që kanë të bëjnë me marrjen e masave të sigurimit të padisë, të regjistruara për periudhën deri më datë 16.03.2021, si më poshtë:
 1. Periudha: deri më datë 06.03.2021 - z. {...};
 2. Periudha: 07.03.2021 - 11.03.2021 - z. {...};
 3. Periudha: 12.03.2021 - 16.03.2021 - znj. {...}.
2. Ky vendim i njoftohet gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

